

Njoftim

Sot, më datë **09.05.2023, ora 13:30**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Sokol Ibi (Relator);**
- 2. Edlira Petri (Anëtare);**
- 3. Alma Kolgjoka (Anëtare);**
- 4. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 5. Blerona Hasa (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e godinës “Poli i Drejtësisë”, salla e konferencave të KLGJ-së, në adresën: Rruga “Ana Komnena”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.17 Regj.Themeltar, Datë 06.05.2023 Regjistrimi, me:

Paditwse: Partia e Lirisë, përfaqësuar nga Altin Kaziaj.

I paditur: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – KQZ.

Person i interesuar: Partia PDIU, përfaqësuar nga Shkëlqim Sulo dhe Klardi Xhemali.

Objekti: Ndryshimin e Vendimit nr.71, datë 02.05.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur:
Caktimin e Partia e Lirisë si parti politike që i lind e drejta e propozimit për anëtarin e katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Baza ligjore: Neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ, Nenet 4, pika 1, Nenet 9, Neni 45, Neni 46 e vijues të Kushtetutës së Shqipërisë, Nenet 63, 64, 65, 98, 139, 145 e vijues i Kodit Zgjedhor të RSH.

me Vendimin Nr.17, datë 09.05.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, unanimisht,

Vendosi:

1. Pranimin pjesërisht të padisë.
2. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit Nr.71 Dt.02.05.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS).

3. Detyrimin e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS), të marrë vendim brenda datës 10.05.2023, lidhur me Kërkesën Ankimore Nr.53 Dt.27.04.2023, depozituar nga subjekti zgjedhor “Partia e Lirisë”.
4. Pushimin e gjykimit lidhur me kërkimin tjetër objekt padie.
5. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.
6. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë më datë 09.05.2023.

Tiranë, më 09.05.2023

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë